



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komunës - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 2408 /2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 12, 40, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 28 paragrafi 5 duke u bazuar në Rregulloren për Taksa Komunale numër 01/nr.7314/2019 të Komunës Hani i Elezit për vitin 2020, neni 12 dhe 15, Situatën e krijuar nga pandemia Covid 19, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 30.04.2020 merr:

VENDIM
PËR LIRIMIN NGA TAKSAT KOMUNALE DHE NGA QIRATË SUBJEKTET
AFARISTE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

1. Me këtë vendim LIROHEN nga pagesa e taksave për ushtrimin e veprimtarive afariste (subjektet afariste) për tre muaj dhe nga pagesa e qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale për gjashtë muaj.
2. Duke ju referuar nenit 1 të këtij vendimi, lirimi nga pagesa bëhet për shkak të gjendjes së pandemisë Covid 19.
3. Obligohen drejtoritë përkatëse që të bëjnë evidentimin e subjekteve afariste dhe ndërmarjen e veprimeve për realizimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja e Financave,
- Drejtorja për Zhvillim Ekonomik,
- Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.04.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

